



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 168

Tiranë – E premte, 18 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 9.9.2020	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe organizatës “ <i>Albanian Roots INC</i> ”..... 12065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 716, datë 16.9.2020	Për miratimin e strukturës e të niveleve të pagave të përfaqësuesve të disa institucioneve të administratës shtetërore në rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion..... 12068
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 16.9.2020	Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë dhe Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi e zyrës koordinuese të tij në Plavë..... 12070
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 718, datë 16.9.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 328, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhës, në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim ‘Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)’, me vendndodhje në lagjen ‘30-vjetori’, Berat, dhe shfuqizimin e vendimit nr. 114, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, ‘Për kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr. 1, dhe objektit nr. 2, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim ‘Qendër mobilizimi’, me vendndodhje në Berat” 12070
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 16.9.2020	Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), dhe Kfw Frankfurt am Main (Kfw), për financimin e shërbimeve të ekspertit për përgatitjen e programit të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe miqësor ndaj klimës..... 12072

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 720, datë 16.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.....	12078
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 16.9.2020	Për dhënien e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, të miratuar me vendimin nr. 668, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave.....	12081
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 727, datë 16.9.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore private parauniversitare, “ <i>Memorial International School of Tirana (MIST)</i> ”.....	12082
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 16.9.2020	Për deklarimin pasuri kulturore “Qendër historike” të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.....	12083
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 16.9.2020	Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Manzë, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese.....	12091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 16.9.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Kurbin, Lezhë dhe Durrës.....	12093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 16.9.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë.....	12093



VENDIM
Nr. 713, datë 9.9.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ORGANIZATËS “ALBANIAN ROOTS
INC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe organizatës “ALBANIAN ROOTS INC”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT MINISTRAVE DHE
“ALBANIAN ROOTS INC”, PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS
FATKEQËSISË**

Sot, në datën . . 2020, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës “ALBANIAN ROOTS INC”, person juridik i regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shtetit të *New York*-ut, me NUIS 45-3978077, me seli në adresën: “2744 Hyland Blvd STE 513, Staten Island, NY, USA, i përfaqësuar nga z. Marko Kepi, shtetas amerikan, mbajtës i kartës së identitetit me nr. C05688452, banues në SHBA, madhor me zotësi të plotë

juridike për të vepruar, referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët” dhe secilit prej tyre si “Pala”.

Duke qenë se:

A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019, në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, dhe me vendimin nr. 751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarqet Lezhë.

B. Ligji nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse, si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta, të cilat, nëpërmjet donacioneve, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.

C. Me anë të vendimit të Komisionit Shtetëror për Rindërtim nr. 31, datë 2.7.2020, është miratuar donacioni në masën prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) USD, i mbledhur nga organizata “ALBANIAN ROOTS INC” në bashkëpunim me gazetarin Marin Mema për ndërtimin e 44 banesave individuale në territorin prej 27,500 m², në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, sipas projekteve model të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, duke marrë përsipër edhe hartimin e Planit të Detyruar Vendor të kësaj zone.

D. Me vendimin nr. 561, datë 15.7.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, është shpallur si zonë e re për zhvillim, territori prej 27.500 m², në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm.

E. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë,



vendës ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.

F. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e “Projektit”, në funksion të procesit të rindërtimit në një nga territoret e zonave të prekura në Zonën e Re për Zhvillim, në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, në masën prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) USD, për hartimin e PDYV të kësaj zone dhe ndërtimin e 44 banesave individuale, sipas projekteve model të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave (referuar në vijim si “Projekti”), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Palët, në referim të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, bien dakord si më poshtë vijon.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshjeje është hartimi i PDyV-së së zonës së re të shpallur për zhvillim të detyruar, si dhe realizimi i punimeve për ndërtimin e 44 banesave individuale, sipas projekteve model të miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

1.2 Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, Detyrën e Njesisë Zbatuese për përgatitjen e sheshit të ndërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për ndërtimin e banesave individuale, sipas propozimit të Donatorit, do ta kryejë Bashkia Durrës.

Neni 2

Masa e Donacionit

2.1 Masa e donacionit, sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, është në vlerën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) USD.

2.2 Donacioni, sipas kësaj marrëveshjeje do t’u nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1 Bashkia Durrës, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, do të asistojë Donatorin në hartimin e PDyV e zonës së re për zhvillim të shpallur me VKM-në nr. 561, datë 15.7.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, e cila duhet të hartohet në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore” dhe do të miratohet nga Bashkia Durrës.

3.2 Bashkia Durrës do të marrë përsipër të garantojë vendosjen në dispozicion të Donatorit të territorit prej 27,500 m², të shpallur si zonë e re për zhvillim të detyruar me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 15.7.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, në fshatin Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për kryerjen e punëve dhe të shërbimeve, objekt i kësaj marrëveshjeje, në kuadër të zbatimit të “Projektit”.

3.3 Midis Donatorit dhe Bashkisë Durrës do të lidhet marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit.

3.4 Të gjitha lejet e nevojshme, me qëllim realizimin e këtij “Projekti”, do të sigurohen nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacioni shqiptar, nëpërmjet Bashkisë Durrës.

3.5 Normat e projektimit dhe e zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.

3.6 Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 354, datë 11.5.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” do të realizohen nga Bashkia Durrës, dhe vlera e këtyre shërbimeve do të financohet nga programi i rindërtimit.



3.7 Kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët për realizimin e “Projektit” do të përzgjidhen nga Donatori, të cilët do të zbatojnë projektet model të banesave individuale të miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave.

3.8 Në lidhje me truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i sheshit të ndërtimit do të bëhet nga Bashkia Durrës.

3.9 Të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me palët e treta që gjenden brenda sheshit të ndërtimit (shpronësimi, nxjerrja e njerëzve nga godinat në përdorim, shembja e objekteve, të gjitha përgjegjësitë ligjore ndaj personave që detyrohen të dalin nga sheshi i ndërtimit, si pasojë e zbatimit të projektit) i takojnë Bashkisë Durrës.

3.10 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

3.11 Në përfundim të realizimit të projektit, Donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave, i cili me vendim, i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, Bashkia Durrës.

3.12 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të “Projektit” do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga Bashkia Durrës.

3.13 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim dhe do t'i dërgohet dorazi ose me postë rekomande në adresat e mëposhtme:

Organizata “ALBANIAN ROOTS INC”

Adresa: 2744 Hyland Blvd STE 513, Staten Island, NY, USA

Çdo njoftim ndaj pranuesit të donacionit do të adresohet te:

Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë

<https://rindertimi.gov.al/>

Email: Sekretariati.Rindertimi@kryeministria.al

Çdo ndryshim i adresës i njërës Palë do duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5

Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7

Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën në lidhje me realizimin e Projektit do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

Për sa më sipër, të nënshkruarit kanë nënshkruar kontratën në 4 (katër) origjinale.

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020
**MINISTRI I
SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN**
Arben Ahmetaj

Nënshkruar në Tiranë,
më 2020
**DONATORI
ORGANIZATA
“ALBANIAN ROOTS
INC”**
Z. Marko Kepi



VENDIM
Nr. 716, datë 16.9.2020

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
PËRFAQËSUESVE TË DISA
INSTITUCIONEVE TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE NË
RRJETIN E KOORDINATORËVE
ANTI-KORRUPSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

1.1 Në nivel qendror: Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Drejtoria Qendrore e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit

Parauniversitar dhe Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

1.2 Në nivel rajonal: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

2. Institucionet e administratës shtetërore, të përcaktuara në pikat 1.1 dhe 1.2, të këtij vendimi, përfaqësohen në Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion nëpërmjet “Koordinatorit”, që është një pozicion pune, pjesë e strukturës dhe organikës së tyre.

3. Kategoritë e pagave të pozicioneve “Koordinator”, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, për institucionet e përcaktuara në pikën 1.1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Kategoritë e pagave të pozicioneve “Koordinator”, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, për institucionet e përcaktuara në pikën 1.2, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Elementet e strukturës së pagës për secilën kategori, të përcaktuara në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i secilit institucion të përcaktuar në pikat 1.1 dhe 1.2, të këtij vendimi, dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Lidhja nr. 1

Kategoritë e pagave për pozicionet “Koordinator”, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion për institucionet e përcaktuara në pikën 1.1, të vendimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Koordinator në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	II-a	1
Koordinator në: Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara; Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; Drejtorinë e Përgjithshme Detare; Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural; Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit; Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar; Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.	II-b	1
Koordinator në: Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;	III-a	1

Lidhja nr. 2

Kategoritë e pagave për pozicionet “Koordinator”, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion për institucionet e përcaktuara në pikën 1.2, të vendimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Koordinator në Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	III-a	1
Koordinator në Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.	III-a/1	1
Koordinator në: Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar.	III-b	1

Shënim: Kategorizimi i drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e këtij institucioni.



VENDIM
Nr. 717, datë 16.9.2020

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
MBËSHTETJEN E FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË
SERBI DHE ZYRAVE TË TIJ NË
PRESHEVË E MEDVEGJË DHE
KËSHILLIT KOMBËTAR TË
SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI E ZYRËS
KOORDINUESE TË TIJ NË PLAVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe të zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë dhe Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi e të zyrës koordinuese të tij në Plavë, në masën:

a) 40 000 (dyzet mijë) euro, për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe të zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë;

b) 30 000 (tridhjetë mijë) euro për Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi dhe të zyrës koordinuese të tij në Plavë.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin “Shpenzime diplomatike jashtë shtetit”, në zërin “Shpenzime korrente”, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 70 000 (shtatëdhjetë mijë) eurosh, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 718, datë 16.9.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 328, DATË 22.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT,
TË KATIT PËRDHES, NË OBJEKTIN
NR. 1, TRE KAT, PJESË TË PRONËS NR.
1047, ME EMËRTIM ‘REPARTI
USHTARAK NR. 6620 (PU)’, ME
VENDNDODHJE NË LAGJEN ‘30-
VJETORI’, BERAT, DHE SHFUQIZIMIN
E VENDIMIT NR. 114, DATË 17.2.2016, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR
KALIMIN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT
SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË
KATIT TË PARË E TË KATIT TË DYTË
TË OBJEKTIT NR. 1, DHE OBJEKTIT
NR. 2, PJESË TË PRONËS NR. 1047, ME
EMËRTIM ‘QENDËR MOBILIZIMI’, ME
VENDNDODHJE NË BERAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 328, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes të Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr. 1, tre kat,



pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)”, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për vendosjen dhe zhvillimin e aktivitetit të administratës së Drejtorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit, në Berat.”.


2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Shërbimi Informativ i Shtetit

të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)”, sipas planimetrisë, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe





VENDIM
Nr. 719, datë 16.9.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (MARRËSI), DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË
EKSPERTIT PËR PËRGATITJEN E
PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË
QËNDRUESHËM TË MBETJEVE TË
NGURTA DHE MIQËSOR NDAJ KLIMËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e Shërbimeve të Ekspertit për përgatitjen e programit të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe miqësor ndaj klimës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE FINANCIMI,
DATË 30.7.2020,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (“MARRËSI”) DHE KfW,
FRANKFURT AM MAIN (KfW) PËR
1,800,000.00 EURO

Për Shërbime të Ekspertit për Marrësin për përgatitjen e Programit të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Mbetjeve të Ngurta dhe Miqësor ndaj Klimës (BMZ nr. 201868199) të financuar nga

një fond i posaçëm (*Studien – und Beratungsfonds*) nr. 21003 të dhënë nga Qeveria e Republikës Federale Gjermane.

Përmbajtja

Neni 1 – Shuma dhe qëllimi i Kontributit Financiar

Neni 2 – Disbursimi

Neni 3 – Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

Neni 4 – Kostot dhe detyrimet publike

Neni 5 – Deklaratat kontraktuale dhe prokura e përfaqësimit

Neni 6 – Shërbimet e ekspertit

Neni 7 – Shërbimet e konsulentëve

Neni 8 – Publikimi dhe transferimi i Shërbimeve të Ekspertit – informacione të lidhura

Neni 9 – Dispozita të ndryshme

Angazhimet e Pajtueshmërisë

Mbi bazën e autorizimit të dhënë nga Qeveria e Republikës Federale Gjermane, datë 20 shkurt 2019, Marrësi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Financimit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep Marrësit një Kontribut Financiar që nuk kalon shumën 1,800,000.00 euro (Kontributi Financiar).

Ky Kontribut Financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi e përdor Kontributin Financiar ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të mëposhtme të ekspertit:

Mbështetje për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (që vepron nëpërmjet Agjencisë së saj Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, si Njësia e Koordinimit të Programit, “NJKP”) gjatë fazës së përgatitjes së Programit të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Mbetjeve të Ngurta dhe Miqësor ndaj Klimës (Programi), duke përgatitur studime fizibiliteti për vendndodhjet e përzgjedhura të projektit (Shërbime të Ekspertit).

1.3 Marrësi, nëpërmjet NJKP-së, paguan kontributin e tij përkatës plotësisht dhe në kohën e duhur. Marrësi, nëse i kërkohet, vë në dispozicion të KfW-së evidenca që provojnë masat e marra për këtë qëllim.



1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin nga Marrësi dhe detyrimet e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2 Disbursimi

2.1 Marrësi, nëpërmjet NJKP-së, autorizon KfW-në të kryejë pagesa të përkohshme dhe përfundimtare nga Kontributi Financiar për Konsulentin (siç përcaktohet në nenin 6.1 (a)). Këto pagesa kryhen në përputhje me ecurinë e Shërbimeve të Ekspertit, përkatësisht në bazë të faturave origjinale që i paraqiten KfW-së (një kopje NJKP-së) dhe në përputhje me kontratat e lidhura ndërmjet NJKP-së dhe Konsulentit (Kontrata e Konsulencës). Ky autorizim nga Marrësi do të konsiderohet se është një kërkesë për disbursim për të gjitha pagesat e lartpërmendura.

2.2 Për pagesat e kryera në një monedhë tjetër, përveç asaj (Valutës së Huaj) të përdorur, KfW-ja do të debitojë Marrësin me një shumë të tillë në euro, siç ishte shpenzuar nga KfW-ja për blerjen e Valutës së Huaj, duke përfshirë shpenzimet e paparashikuara.

2.3 KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare që kryejnë disbursimin ose dërgimin e çdo pagese nga KfW-ja. Në rast se ndonjë vonesë është shkaktuar nga KfW-ja, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagimin e interesit të akumuluar.

2.4 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2021.

2.5 Kontrata e Konsulencës përfshin një dispozitë që përcakton se çdo rimbursim, garanci apo pagesë e ngjashme e pretendueshme dhe çdo pagesë sigurimi do të kryhet për llogari të Marrësit te KfW-ja. Frankfurt am Main, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, BIC: KFWIDEFF dhe KfW-ja do t'i kreditojë këto pagesa në llogarinë e Marrësit.

Neni 3 Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

- a) Marrësi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesa kur kërkohen;
- b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë shkelur;

c) Marrësi nuk mund të provojë se shumatat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) respektimi i detyrimeve të KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme, të cilat pengojnë apo rrezikojnë seriozisht realizimin e qëllimit të Shërbimeve të Konsulencës; ose

f) Kontrata e Konsulencës nuk është respektuar, ka përfunduar apo është anuluar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Kontributit Financiar, nëse ndonjë prej situatave të përcaktuara në nenin 3.1 (b), (c) dhe (d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, sidoqoftë, do të jetë të paktën 30 ditë. Në rastin e nenit 3.1 (c), shlyerja do të kufizohet për shumata të tilla për të cilat Marrësi nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar. Në rastin e nenit 3.1 (d), shlyerja do të kufizohet për ato shumata, pagesa e të cilave për Marrësin ose lënia e tyre te Marrësi përbën shkelje të ligjeve në fuqi.

Neni 4 Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që rrjedhin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për sa i përket lidhjes dhe realizimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe kostot e transferimit dhe të këmbimit valutor që lindin në lidhje me disbursimet e Kontributit Financiar.

Neni 5 Deklaratat Kontraktuale dhe Prokura e Përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj ndaj KfW-së dhe të autorizuar me modele nënshkrimesh të certifikuara prej tij ose saj përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Prokura e përfaqësimit nuk skadon derisa revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Marrësit i autorizuar për atë kohë, të merret nga KfW-ja.

5.2 Ndryshimet apo shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të jetë i



miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 2.4) nuk kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

5.3 Çdo njoftim apo deklaram, sipas kësaj Marrëveshjeje, çmohet i marrë sapo mbërrin në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese që i njoftohet palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)
Faks: +49 69 7431 - 2944
Për Marrësin: Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Shqipëri
Faks: + 35542228494

Neni 6

Shërbimet e Ekspertëve

6.1 Marrësi

a) nëpërmjet NJKP-së ua cakton Shërbimet e Ekspertit konsulentëve të pavarur të kualifikuar (Konsulenti) me praktika të qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me konceptimin ndërmjet NJKP-së dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertit;

b) nëpërmjet NJKP-së, në vijim të përzgjedhjes paraprake dhe ofertimit publik konkurrues ndërkombëtar, ia cakton Kontratën e Konsulencës një Konsulentit të pavarur të kualifikuar. Procedura e dhënies së Kontratës së Konsulencës rregullohet nga “Udhëzime për prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës, punëve, instalimeve, mallrave dhe shërbimeve jokonsulente në bashkëpunim financiar me vendet partnere” (versioni i datës 21.1.2019, siç është publikuar në faqen e internetit të KfW-së në datën e kësaj marrëveshjeje: https://www.KfW-entwicklungsbank.de/PDF/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/Vergaberichtlinien-2019-Englisch-Internet_2.pdf);

Faqe | 12074

c) nëpërmjet NJKP-së siguron financimin e plotë të Shërbimeve të Konsulencës dhe i jep KfW-së, me kërkesën e saj, prova që vërtetojnë se janë mbuluar kostot e papaguara nga ky kontribut;

d) nëpërmjet NJKP-së mban ose merr masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave, që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e lindura në lidhje me Shërbimet e Konsulencës dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar;

e) nëpërmjet NJKP-së u mundëson përfaqësuesve të KfW-së, në çdo kohë, inspektimin e këtyre librave dhe regjistrave dhe të çdo dokumentacioni tjetër që ka lidhje me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit;

f) nëpërmjet NJKP-së i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertit dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç mund të kërkohej nga KfW-ja;

g) me nismën e vet, nëpërmjet NJKP-së, informon menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që pengon apo rrezikon seriozisht zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit apo qëllimin e tyre;

h) nëpërmjet NJKP-së komenton mbi raportet e Konsulentit ose vërteton miratimin e NJKP-së të përmbajtjes me anë të një siglimesi të raporteve; dhe

i) nëpërmjet NJKP-së merr vendimin e tij për të gjitha skicat, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të Konsulentit në marrëveshje me KfW-në.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të Shërbimeve të Ekspertit të porositura, KfW-së i vihen në dispozicion një numër kopjesh të të gjitha skicave, raporteve, studimeve të hartuara nga Konsulenti, siç mund të kërkojë KfW-ja. KfW-ja mund t'i vlerësojë këto studime.

6.3 Nga financimi i Shërbimeve të Ekspertit, Marrësit mund të mos i burojë e drejta e financimit të projektit të përgatitur nga Shërbimet e Ekspertit. Megjithatë, Marrësi i jep Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për të financuar projektin, në kuadër të Bashkëpunimit Financiar, nëse është e nevojshme.

Neni 7

Shërbimet e Konsulencës

7.1 Detyrat e Konsulentit përfshijnë

- rishikimin dhe specifikimin e masave të parashikuara të investimit;



- krahasimin e masave teknike alternative;
- analizimin e fizibilitetit teknik të masave të parashikuara të investimit;
- analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore;
- specifikimin e ndikimeve mjedisore dhe klimatike;
- aspekte të operimit që përfshijnë kostot operative dhe tarifat.

7.2 KfW-ja ka të drejtën e pakufizuar të përdorë dhe të shfrytëzojë, në çdo kohë dhe në çdo vend, sipas diskrecionit të saj, rezultatet e Shërbimeve të Ekspertit dhe të gjitha dokumentet e lidhura me to dhe që janë financuar nga Kontributi Financiar.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i Shërbimeve të Ekspertit – informacionet e lidhura

8.1 KfW-ja, për të qenë në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës dhe efikasitetit më të lartë në bashkëpunimin për zhvillim, publikon informacione të përzgjedhura (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si ato janë financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/et që lidhet/n me këto shërbime eksperti po zbatohet/en dhe gjatë fazës paskontraktuale (në vijim e referuar si “e Gjithë Periudha”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për zonën e saj të biznesit “KfW Development Bank” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacioneve (nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si janë financuar, nuk përfshin dokumentacionin kontraktual apo ndonjë informacion sensitiv të detajuar financiar apo që ka lidhje me biznesin rreth palëve të përfshira në Shërbimet e Ekspertit apo financimin e tyre, të tilla si:

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme korporative;
- d) të dhëna personale të personave fizikë;
- e) klasifikimi i brendshëm i KfW-së, i pozicionit financiar të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si janë financuar gjatë të Gjithë Periudhës me palët e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe eficiencë:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale Gjermane dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo entet e saj kompetente;

c) organizatat e tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizatat ndërkombëtare të përfshira në grumbullimin e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale Gjermane ka kërkuar që KfW-ja të ndajë informacione të përzgjedhura për Shërbime të Ekspertit dhe mënyrën se si ato janë financuar gjatë të Gjithë Periudhës me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë pjesë të lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale Gjermane, për qëllime të Nismës së Transparencës për Ndihmën Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) *Germany Trade & Invest (GTAI)*, për qëllime të informacioneve për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja, për qëllime të raportimit të flukseve financiare, në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (Deval), për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe eficiencë (<http://www.deval.org/de/>).

8.4 KfW-ja, më tej, rezervon të drejtën të transferojë (duke përfshirë për qëllime publikimi) informacione për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si janë financuar ato gjatë të Gjithë Periudhës, te palë të tjera të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave legjitimë.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat legjitimë të Marrësit për mostransferimin e informacionit



tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e tij. Interesat legjitimë të Marrësit përfshijnë, veçanërisht, konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë t'u transferojë informacione palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore apo të shpallë ose të mbrojë pretendime ose të drejta të tjera ligjore në procedime gjyqësore apo administrative.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 1 (Angazhimet e pajtueshmërisë).

9.2 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Marrësi nuk mund të caktojë, transferojë, lërë peng apo rëndojë me hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i ekzekutimit të Marrëveshjes është Frankfurt am Main. Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

9.5 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi sapo KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga Marrësi se kanë përfunduar procedurat e brendshme ligjore që duhen përmbushur nga Marrësi.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
më _____. _____. 2020
KfW

Nënshkrim
Nënshkrim

Tiranë,
më 30 korrik 2020
Nënshkrim
Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë

Shtojcë 1: Angazhimet e pajtueshmërisë

SHTOJCAT

SHTOJCË 1

ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë Shtrënguese”, dëmtimi apo cenimi ose kërcënimimi për të dëmtuar apo cenuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person apo pasuri të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë”, një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e synuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi apo kërkimi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme apo avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi apo marrjen e masave që çfarëdo personi të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

“Praktikë mashtruese”, çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që qëllimisht apo nga pakujdesia mashtron apo synon të mashtrojë një person për të marrë një përfitim financiar apo për të shmangur një detyrim.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi apo fshehja e provave materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin apo kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese apo praktikë të fshehtë apo kërcënimimi, ngacmimi ose frikësimi i cilitdo person për ta penguar atë që të zbulojë informacionet e tij për çështjet e lidhura me hetimin apo nga ndjekja e hetimit; apo ii. çdo veprim që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale, në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese apo praktikë të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, person juridik, partneritet apo shoqëri e pathemeluar.



“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese apo praktikë penguese (siç janë përcaktuar këta terma këtu), e cila: i. është e paligjshme sipas ligjit gjerman apo ndonjë ligji tjetër në fuqi; dhe ii. e cila ka apo potencialisht mund të ketë një efekt ligjor material apo reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimit të saj.

“Sanksione”, ligjet për sanksionet ekonomike, financiare apo tregtare, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese të administruara, të miratuara apo të zbatuara nga cildo organ sanksionues.

“Organ sanksionues”, cildo prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve” çdo listë me persona, grupe apo ente të caktuara specifikisht, të cilët u nënshtrohen sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Marrësi:

a) do të vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet që kanë lidhje me “njihni klientin tuaj” apo informacione të ngjashme për Marrësin, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet NJKP-së, t’i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Marrësit dhe të palëve të tij (nën) kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, për Shërbimet e Ekspertit që janë të nevojshme për KfW-në për të përmbushur detyrimet e saj, në mënyrë që të parandalojë çdo praktikë të sanksionueshme, pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Marrësin, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) nëpërmjet NJKP-së, të informojë KfW-në menjëherë dhe me nismën e vet, sapo vihet në dijeni apo dyshon për çfarëdo praktikë të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit që ka lidhje me Shërbimet e Ekspertit;

d) nëpërmjet NJKP-së, t’i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertit dhe ecurinë e mëtejshme të tyre, siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) nëpërmjet NJKP, t’i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj në çfarëdo kohe, të inspektojnë të gjithë dokumentacionin e Marrësit dhe të palëve të tij (nën) kontraktuese dhe palëve të tjera, që ka lidhje me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertit për qëllime të kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman apo ligjin e vendit të Marrësit, ky i fundit përfaqëson se asnjë nga personat, të cilët veprojnë në lidhje me Shërbimet e Ekspertit në emër të Marrësit, nuk ka kryer apo nuk është i angazhuar në asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia të parashtruara në këtë nen kryhen për herë të parë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Do të konsiderohet që të përsëritet pas çdo tërheqjeje të Kontributit Financiar, duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi merr përsipër, sapo Marrësi apo KfW-ja vihen në dijeni apo dyshojnë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave apo financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Marrësi do të përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW-ja dhe do të sigurojë mbështetje dokumentuese për një përgjigje të tillë, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk do të kryejë asnjë transaksion, as nuk do të angazhohet në asnjë aktivitet tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertit që do të përbënin shkelje të sanksioneve.



VENDIM

Nr. 720, datë 16.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 77, DATË 28.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KONTRIBUTET E DETYRUESHME
DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SIGURIMI I KUJDESIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 9, 10, 11, 13, 15 dhe 99, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”; të nenit 4, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”; të nenit 6, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve të nëntokës”; të nenit 8, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, dhe të neneve 6, 8 e 9, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “e”, e pikës “1”, të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Personat e vetëpunësuar si shitës ambulantë, sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “j”, të nenit 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, të jetë, si më poshtë vijon:

a) jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 111, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1996, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe deri në një pagë maksimale që llogaritet sipas përcaktimeve në paragrafin e dytë, të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për personat e punësuar;

b) jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi, dhe nëse e kërkon vetë personi deri në pagën maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve;

c) e barabartë me pagën minimale mujore në shkallë vendi për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht;

ç) mund të jetë më e ulët se paga minimale në shkallë vendi, në varësi të kohës efektive të punës, për invalidët e punësuar, të vetëpunësuar dhe anëtarë të papaguar të familjes, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, si më poshtë vijon:

i. për invalidët e vetëpunësuar dhe anëtarët e papaguar të familjes invalidë, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, mund të jetë deri në 25% më e ulët se paga minimale;

ii. për invalidët e punësuar, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, të jetë sipas kohës së punës dhe pagës faktike, por jo më pak se 50% e pagës minimale dhe jo më shumë se paga



maksimale e përcaktuar për efekt të derdhjes së kontributeve.”.

b) shkronjat “ a” dhe “b”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;

b) sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuar punon e bashkëjeton ligjërisht;”.

c) fjalja e parë, e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme, të jetë jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës.”.

c) pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Paga, për efekt të llogaritjes së kontributeve shtesë, në zbatim të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, dhe nenit 8, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, të jetë sipas përcaktimeve në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij kreu.”.

3. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikën 11, fjalët “... të jetë 0.3% e pagës bruto minimale e barabartë me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... është 0.3% e pagës bruto minimale në shkallë vendi ...”.

b) në pikën 12, fjalët “... e barabartë me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.” hiqen.

c) në pikën 15, pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh”, “e” dhe “ë”, me këtë përmbajtje:

“dh) Për personat me titull shkencor, të punësuar në një ose më shumë subjekte, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, të cilët realizojnë një pagë mujore gjithsej të barabartë ose më të madhe se paga e përcaktuar për titullin shkencor përkatës në sektorin publik, kontributi i sigurimit suplementar llogaritet bazuar në pagën referuese të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, sipas titujve, në institucionet publike. Nëse paga referuese e titullit

arrihet nga puna vetëm në njërin prej subjekteve, kontributi suplementar përlogaritet vetëm në subjektin e parë, ndërsa në subjektin e dytë nuk llogaritet kontributi. Në rastet kur paga mujore gjithsej, e realizuar në një ose më shumë subjekte, është më e vogël se paga referuese e përcaktuar për titullin shkencor, subjektet përkatëse nuk llogarisin kontribut suplementar dhe për rrjedhojë muaji pa kontribut, nuk njihet si periudhë për përfitime suplementare.

e) Kur i njëjti person i plotëson kushtet për pjesëmarrje në më shumë se një nga skemat e sigurimit suplementar, në të njëjtin muaj, ai ka të drejtën të zgjedhë pjesëmarrjen dhe pagesën e kontributeve, vetëm në njërin nga skemat suplementare. Zgjedhja e skemës bëhet nga personi i interesuar dhe i njoftohet punëdhënësit.

ë) Rimbursimi i kontributeve të paguara më tepër se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale mujore mbi të cilën llogariten kontributet bëhet nga subjekti përkatës me kërkesë e miratim në organet tatimore, nëpërmjet rivlerësimit të listëpagesave, duke e kaluar shumën e mbipaguar të kontributit të sigurimeve shoqërore:

i. në mbulim të detyrimeve kontributive të personit për periudhat e ardhshme;

ii. duke kthyer shumat e mbipaguara;

iii. rregullat e llogaritjes së kontributeve, të deklarimit dhe të rimbursimit të kontributeve të paguara më tepër se detyrimet ligjore, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”.

c) pikat 18 dhe 19 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“18. Për personat që kryejnë funksione kushtetuese, si dhe punonjësit e lartë të shtetit, për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të parakohshëm, buxheti i shtetit derdh kontribute, për degën e pensioneve, në masën 21.6% të pagës mesatare referuese, sipas gradës dhe funksionit në momentin e përfundimit të funksionit, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar.

19. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake që përfitojnë trajtim financiar të veçantë,



personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension, për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdhi kontribute për degën e pensioneve në masën 21.6% të pagës minimale në shkallë vendi. Për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, buxheti i shtetit derdhi kontribute edhe për degën e barrë lindjeve dhe aksidenteve në punë në masën 1.7 % të pagës minimale në shkallë vendi.”.

d) në fund të pikës 20 shtohen fjalët “... në shkallë vendi.”.

4. Në pikën 11, të kreut IV, fjalët “... për vitin 2016 ...” zëvendësohen me “... për vitin 2020 ...”.

5. Në kreun VII bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Baza e vlerësuar mesatare mujore, për efekt të llogaritjes së përfitimit, është e barabartë me pagën bruto mujore, mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore të periudhës, të realizuar në një ose më shumë subjekte, por jo më shumë se paga maksimale e përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi, pjesëtuar me shumën e muajve të periudhës së përcaktuar.”.

b) në fund të pikës 6 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për sëmundje, nga dita e 15 (pesëmbëdhjetë) e raportit mjekësor e në vazhdim, për kompensim sëmundjeje dhe për llogaritjen e të ardhurave për paaftësi të përkohshme në punë, nga aksidentet ose sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit ose për disa muaj, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, për arsye se ka qenë në periudhë përfitimi në një nga degët e sigurimit të detyrueshëm shoqëror është e barabartë me bazën e vlerësuar mujore të llogaritur për efekt të përfitimeve të mëparshme. Përfitimet afatshkurtra për llogariten bazuar në bazën e vlerësuar mesatare neto.”.

6. Në kreun VIII bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i. në paragrafin e parë, fjalët “... nga data 1.8.2016 e në vazhdim, të jetë 12 635 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë ...” zëvendësohen me “... nga data 1.4.2020 e në

vazhdim përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve ...”.

ii. në paragrafin e tretë, fjalët “... 14 285 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj.” zëvendësohen me “... shuma sipas periudhave, e përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve.”.

b) në pikën 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. fjalët “... nga data 1.8.2016 e në vazhdim, përfshi edhe këtë datë, të jetë 6 858 (gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.” zëvendësohen me “... nga data 1.4.2020 e në vazhdim, përfshi edhe këtë datë, të jetë 7 637 (shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë lekë).”.

ii. në fund të pikës shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për vitet në vazhdim, kur plotësohet periudha e sigurimit sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë do të jetë e barabartë me masën e pensionit të plotë social të përcaktuar për atë periudhë me vendim të Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve.”.

7. Në kreun XI shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Në mbështetje të paragrafit të fundit, të nenit 6, dhe të paragrafit të dytë të nenit 98, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar:

Personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm kanë të drejtë ta marrin pensionin e invaliditetit edhe kur janë të punësuar ose të vetëpunësuar. Këta persona, kur punojnë si të punësuar apo të vetëpunësuar në sektorin privat, e marrin pensionin mujor të caktuar, pavarësisht nga shuma e të ardhurave mujore që realizojnë nga punësimi apo vetëpunësimi. Ndërrerja e përfitimit të kësteve mujore të pensionit të invaliditetit përcaktohet vetëm me vendim të arsyetuar të Komisionit Mjekësor të Aktimit të Aftësisë për Punë, pas shqyrtimit të gjendjes aktuale shëndetësore të invalidit, zbatimit prej tij të këshillave mjekësore të përcaktuara lidhur me punën dhe kohëzgjatjen e saj, aftësisë për të kryer punë të përshtatshme në varësi të gjendjes



shëndetësore dhe respektimit të kriterëve ligjore të përfitimit, të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 721, datë 16.9.2020

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR NJË
NDRYSHIM NË KONTRATËN E
QIRASË ME TARIFËN 1
EURO/KONTRATA, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 668, DATË 29.7.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, miratuar me vendimin nr. 668, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë ‘MUKA’ sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë ‘Magazina nr. 145’, në Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan”, sipas projektkontratës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja e Prodhimit të Çeliqueve Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ rep.

Nr. _____ kol.

PROJEKT KONTRATË
ANEKS KONTRATË QIRAJE

lidhur

në Tiranë, sot më datë ____ të muajit _____ të vitit 2020 (dymijë e njëzetë), u paraqiten para meje noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ nga z. _____ me detyrë _____, në këtë Ministri, i datëlindjes _____, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare i pajisur me letërnjoftimin me numër personal _____, që më poshtë do të quhet **“Qiradhënës”**;

dhe

shoqëria “MUKA 1741” SHPK me seli në Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me numër identifikimi L93623203L, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Gilman Muka, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal _____, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **“Qiramarrësi”**;

të cilët deklaruan se:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mori në shqyrtim kërkesën datë 24.6.2020, të shoqërisë “Muka 1741” sh.p.k., protokolluar me nr. 11901, datë 24.6.2020, e cila ka kërkuar që të bëhet një ndryshim në kontratën e qirasë me çmimin 1 euro/kontrata nr. 5931 rep., nr. 1867 kol., datë 20.8.2015, lidhur me emrin e shoqërisë “MUKA” sh.p.k., duke e zëvendësuar me shoqërinë “MUKA 1741” sh.p.k., numër identifikimi L93623203L. Mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve,



të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. ____ datë _____.2020, të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, të miratuar me vendimin nr. 668, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave”, dhe udhëzimit nr. 13, datë 26.4.2018, dalë në zbatim të tij, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë anekskontratë.

Neni 1

Në pjesën hyrëse të kontratës së qirasë me çmimin 1 euro/kontrata nr. 5931 rep., nr. 1867 kol., datë 20.8.2015, pala qiramarrëse “MUKA” sh.p.k., me seli në Tiranë, me adresë: rruga “Siri Kodra”, Tiranë, regjistruar me numër identifikimi K22008002D, përfaqësuar nga administratori Belma Muka, identifikuar me nr. 026074557, zëvendësohet me shoqëria “MUKA 1741” sh.p.k., me numër identifikimi L93623203L, me seli në Elbasan, me adresë: Rruga Metalurgji, godina nr. 145, përfaqësuar nga administratori Gilman Muka.

Kudo në kontratën e qirasë nr. 5931 rep., nr. 1867 kol., datë 20.8.2015, shoqëria “Muka” sh.p.k., me numër identifikimi K22008002D, zëvendësohet me shoqëria “Muka 1741” sh.p.k., me numër identifikimi L93623203L.

Neni 2

Anekskontrata është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr. 5931 rep., nr. 1867 kol., datë 20.8.2015 dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i saj, anekskontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Aneks kontrata është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.

QIRADHËNËSI
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Përfaqësuar nga:

QIRAMARRËSI
Shoqëria “MUKA
1741” sh.p.k.
Përfaqësuar nga:
Gilman Muka

VENDIM

Nr. 727, datë 16.9.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE PARAUNIVERSITARE, “MEMORIAL INTERNATIONAL SCHOOL OF TIRANA (MIST)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore private parauniversitare, “*Memorial International School of Tirana (MIST)*”, në të gjitha nivelet arsimore (arsim fillor, arsim i mesëm i ulët, arsim i mesëm i lartë).

2. Institucionet arsimore private parauniversitare, “*Memorial International School of Tirana (MIST)*”, kanë këto detyrime:

a) të pajisin çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi;

c) të kthejnë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të vënë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

d) të dorëzojnë në Arkivin Shtetëror Vendor dokumentacionin dhe të paraqesin në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar një kopje të dokumentacionit dhe të procesverbalit të dorëzimit të tij, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.



3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore private parauniversitare, “*Memorial International School of Tirana (MIST)*”.

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar, për të gjithë nxënësit e regjistruar në këto institucione arsimore;

c) të administrojë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga këto institucione arsimore private parauniversitare.

4. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 25, datë 28.1.2002, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik, “*Memorial International School of Tirana*””; nr. 545, datë 3.8.2005, “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor jopublik parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, cikël i lartë “*Memorial International School*”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze”, si dhe nr. 134, datë 8.3.2006, “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, si shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “*Memorial International School*”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze”, shfuqizohen.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore private parauniversitare, “*Memorial International School of Tirana (MIST)*” dhe shoqëria “*Turgut Ozal Education*” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 729, datë 16.9.2020

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE “QENDËR HISTORIKE” TË FSHATIT KANINË, ZONËS MBROJTËSE TË SAJ, DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, 62, pika 3, dhe 96, pika 1, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore “Qendër historike” të fshatit Kaninë dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozim të strukturave të specializuara, të përcaktojë zonat mbrojtëse të monumenteve të kulturës, të ndodhura brenda pasurisë kulturore.

4. Vendimi nr. 581, datë 13.10.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Kaninë e të zonës së mbrojtur rreth saj dhe miratimin e rregullores për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Kaninë dhe zonës së mbrojtur rreth saj”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e “Qendrës historike” të fshatit Kaninë dhe zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E “QENDRËS HISTORIKE” TË FSHATIT KANINË DHE ZONËS MBROJTËSE TË SAJ

Neni 1

Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “Qendrës historike” të fshatit Kaninë dhe zonës mbrojtëse të saj.

Neni 2

Objekti

Objekti kryesor i këtij plani është:

a) ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të “Qendrës historike” të fshatit Kaninë dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur;

b) administrimi i “Qendrës historike” të fshatit Kaninë dhe zonës mbrojtëse të saj;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për ruajtjen dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të fshatit Kaninë, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Kaninë përbëhet nga:

a) Qendra historike;

b) Zona mbrojtëse.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen ansamble arkitektonike-urbane, monumente kulture të kategorisë I dhe monumente kulture të kategorisë II, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status.

3. Plan i përgjithshëm vendor i Bashkisë Vlorë merr parasysh kufijtë e zonifikimit të “Qendrës historike” të fshatit Kaninë, zonës mbrojtëse të saj, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “Qendrës historike” të fshatit Kaninë, zonës

mbrojtëse të saj dhe monumenteve të kulturës të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Neni 4

Qendra historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike është hapësira urbane që ruan në tërësinë e saj vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, në të cilat dokumentohet rruga e zhvillimit historik të fshatit dhe arritjet arkitektonike-urbanistike. Pjesë përbërëse e saj janë kalaja, ndërtesat, së bashku me elementet urbane përreth, si: sheshet, rrugët, trotualet, muret rrethuese, portat, oborret, strukturat e ndriçimit, dekorit, gjelbërimi.

2. Hapësira urbane e “Qendrës historike” të fshatit Kaninë përbëhet nga Kalaja e Kaninës dhe pjesa e fshatit që zhvillohet në jug të saj.

3. Në “Qendrën historike” ndodhen pasuri kulturore të paluajtshme si monumente kulture të kategorisë I dhe II, dhe objekte pa status.

4. Kufijtë e “Qendrës historike” paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

5. Koordinatat gjeografike të “Qendrës historike” paraqiten në aneksin 1, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse përreth “Qendrës historike” ruan vlera të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, duke plotësuar vlerat e “Qendrës historike”.

2. Zona mbrojtëse me vlerën e saj plotësuese luan një rol me rëndësi në mbrojtjen e vlerave të “Qendrës historike”, duke qenë e pajisur me elemente që u shërbejnë pamjeve panoramike të fshatit.

3. Hapësira urbane e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” në fshatin Kaninë përbëhet nga dy nënzona:

a) nënzona I;

b) nënzona II (zonë e gjelbër).

4. Nënzona I përfshin ndërtimet në pjesën veriore të Kalasë së Kaninës, të cilat ndodhen jashtë zonës mbrojtëse të këtij monumenti, pjesën perëndimore poshtë rrugës kryesore të fshatit, si



dhe pjesët në lindje e në jug të “Qendrës historike” që kanë banesa ekzistuese.

5. Nënzona II përfshin hapësirat e gjelbëruara në pjesën perëndimore të zonës mbrojtëse të “Qendrës historike”, në krah të rrugës kryesore dhe në pjesën lindore të “Qendrës historike”.

6. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

7. Koordinatat gjeografike të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhryrjet e lejuara në “Qendrën historike”

1. Ndërhryrjet në “Qendrën historike” kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të fshatit Kaninë, si dhe kthimin e tij në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar.

2. Brenda kësaj zone lejohen të kryhen:

a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) ndërhryrje restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekture, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave dhe të shesheve publike;

c) rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

ç) rehabilitimi i hapësirave dhe plotësimi i sipërfaqeve të reja, të cilat ndikojnë në vlerat dhe unitetin kompozicional të “Qendrës historike”;

d) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Ndërhryrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhryrjet në monumentet e kulturës dhe zonën mbrojtëse të tyre, të cilat ndodhen në “Qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse, kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Brenda kësaj zone lejohen:

a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 7/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Ndërhryrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “Qendrës historike” të fshatit Kaninë

Ndërhryrjet e lejuara brenda zonës mbrojtëse janë:

a) restaurime, rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

b) studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj, si dhe me qëndrimin karshi ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të zonës mbrojtëse;

c) ndërtime të reja brenda nënzonës I, shtesa dhe përshtatje në sheshe të lira, në harmoni me karakteristikat e “Qendrës historike” me qëllim rritjen e vlerave brenda saj;

ç) rikonstruksione dhe ndërtime të reja të rrjetit rrugor, shesheve, sipërfaqeve të gjelbëruara dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore;

d) rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese nëpërmjet të cilave mund të realizohen parqe dhe elemente të arredimit urban, duke ruajtur gjelbërimin tradicional.

Neni 9

Ndërhryrjet e ndaluara në tërësinë e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Në hapësirën e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet e reja që prekin monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre.

2. Në hapësirën e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.



Neni 10

Kriteret e projektimit për rikonstruksione, ndërhyrjet e lejuara në “Qendrën historike”, monumentet e kulturës dhe zonën mbrojtëse të tyre

1. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “Qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historiko-kulturore të objektit apo monumentit për të cilat janë shpallur pasuri kulturore, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim.

2. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda “Qendrës historike” hartohen:

a) duke u bazuar në studime urbanistike dhe arkitektonike;

b) duke mos dëmtuar karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë. Nga pikëpamja arkitekturore ato duhet të jenë në harmoni me këto banesa, duke respektuar raportet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke ruajtur sa të jetë e mundur karakteristikat origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale;

d) duke u bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese dhe të hapësirave të gjelbra, shesheve brenda zonës mbrojtëse hartohen bazuar në planin e detajuar vendor të Bashkisë Vlorë apo studimet urbanistike e arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë;

b) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

c) duke ruajtur drurët dhe gjelbërimin tradicional të rrugëve dhe shesheve, dhe pas

degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje, nëpërmjet ndërhyrjeve rehabilituese të sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese.

4. Projektet për rehabilitimin e hapësirave dhe plotësimet në sipërfaqet e lira brenda “Qendrës historike” hartohen vetëm për ato territore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan, si dhe ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe rregullave të tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave ekzistuese brenda “Qendrës historike” dhe nga pikëpamja arkitekturore ato duhet të jenë në harmoni me këto banesa, duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike, si dhe altimetrinë përgjatë rrugëve kryesore, por jo më shumë se 7 m nga kuota e terrenit deri në kornizën e çatisë;

b) duke u bazuar në treguesit zhvillimorë të parashikuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Vlorë;

c) duke u bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike;

ç) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë, lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çatave për ndërtimet e reja, që të jenë të të njëjtët lloj me ato të ndërtimeve origjinale përreth;

dh) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymëve dhe të dritareve, ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, si dhe materialin e mureve rrethuese, lartësinë dhe ngjyrat e tyre në harmoni me karakteristikat e “Qendrës historike”.

5. Projektet për ndërtimet e reja, rehabilitimin dhe plotësimet në sipërfaqet e lira brenda nënzonës I, të zonës mbrojtëse, hartohen vetëm në ato territore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan, ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe rregulla të tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në zonën e mbrojtur të “Qendrës historike”;

b) duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore të treguesve zhvillimorë të parashikuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Vlorë;



c) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

ç) duke ruajtur lartësinë maksimale të ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, e cila nuk duhet të kalojë lartësinë maksimale ose numrin e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 3 (tri) kate – 9 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit;

d) duke ruajtur originalitetin e ndërtimit të çatave në rastet e mbulesave me çati të ndërtimeve të reja, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse;

dh) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymve dhe dritareve, si dhe ngjyrat e fasadës së banesës/objektit në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse.

6. Projektet për rikonstruksionin e rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në tërësinë e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj hartohen:

a) bazuar në parashikimet e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Vlorë;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “Qendrën historike”, monumentet e kulturës të veçanta dhe zonën mbrojtëse të tyre

1. Studimet për vlerësimin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në “Qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse të saj, duke përfshirë banesat, fasadat e tyre, muret rrethuese, trotualet, kalldrëmet tradicionale dhe elemente të tjera urbanistiko-arkitektonike, dhe monumenteve të kulturës, hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Vlorë ose/dhe nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimit dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “Qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja Vlorë ose/dhe nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja Vlorë ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, rehabilitimin e hapësirave dhe plotësimi i sipërfaqeve të lira në “Qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja Vlorë ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtime të reja në zonën mbrojtëse hartohen nga subjekte të licencuara për këtë kategori projektesh, sipas ligjit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja Vlorë monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

5. Projektet për ndërtimet e reja apo rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe shesheve në “Qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja Vlorë ose/dhe nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit dhe projektet për realizimin e linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore hartohen nga persona të licencuar sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja Vlorë ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit dhe sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë



kulturore dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Projektet për ndërtimet e reja apo rikonstruksionin e rrjetit rrugor, të shesheve dhe të linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja Vlorë monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

7. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “Qendrën historike” dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, IKTK-ja, DRTK-ja Vlorë

dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në rastet kur projekti parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore, hartimi bëhet nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja Vlorë.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Këtij plani i bashkëlidhet zonifikimi i “Qendrës historike”, zonës mbrojtëse të saj, si dhe tabelat përkatëse të koordinatave gjeografike.

ANEKS 1

KOORDINATAT E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT KANINË

Qendra Historike		
UTM Z 34N		
	Lat.	Long.
K1	40° 26' 36.142" N	19° 31' 18.996" E
K2	40° 26' 36.126" N	19° 31' 20.902" E
K3	40° 26' 36.450" N	19° 31' 22.712" E
K4	40° 26' 37.563" N	19° 31' 23.328" E
K5	40° 26' 37.933" N	19° 31' 25.884" E
K6	40° 26' 37.291" N	19° 31' 27.167" E
K7	40° 26' 37.074" N	19° 31' 31.312" E
K8	40° 26' 38.205" N	19° 31' 32.897" E
K9	40° 26' 39.252" N	19° 31' 33.302" E
K10	40° 26' 40.417" N	19° 31' 31.431" E
K11	40° 26' 41.312" N	19° 31' 30.325" E
K12	40° 26' 43.044" N	19° 31' 31.571" E
K13	40° 26' 44.063" N	19° 31' 32.700" E
K14	40° 26' 46.101" N	19° 31' 33.167" E
K15	40° 26' 46.482" N	19° 31' 32.382" E
K16	40° 26' 46.334" N	19° 31' 31.363" E
K17	40° 26' 44.867" N	19° 31' 27.599" E
K18	40° 26' 43.951" N	19° 31' 24.533" E
K19	40° 26' 44.400" N	19° 31' 24.594" E
K20	40° 26' 45.823" N	19° 31' 21.790" E
K21	40° 26' 46.294" N	19° 31' 19.896" E
K22	40° 26' 46.167" N	19° 31' 19.319" E
K23	40° 26' 46.309" N	19° 31' 18.691" E
K24	40° 26' 45.901" N	19° 31' 16.232" E
K25	40° 26' 45.058" N	19° 31' 14.128" E
K26	40° 26' 45.639" N	19° 31' 10.512" E
K27	40° 26' 45.290" N	19° 31' 8.709" E
K28	40° 26' 44.574" N	19° 31' 7.802" E
K29	40° 26' 43.626" N	19° 31' 7.341" E
K30	40° 26' 43.212" N	19° 31' 6.697" E
K31	40° 26' 42.679" N	19° 31' 6.408" E
K32	40° 26' 42.342" N	19° 31' 6.444" E
K33	40° 26' 41.236" N	19° 31' 6.424" E
K34	40° 26' 39.230" N	19° 31' 6.590" E
K35	40° 26' 37.632" N	19° 31' 7.741" E
K36	40° 26' 35.411" N	19° 31' 9.284" E
K37	40° 26' 35.130" N	19° 31' 12.614" E
K38	40° 26' 34.167" N	19° 31' 14.808" E
K39	40° 26' 32.396" N	19° 31' 16.319" E
K40	40° 26' 29.098" N	19° 31' 14.778" E
K41	40° 26' 27.762" N	19° 31' 14.166" E
K42	40° 26' 26.531" N	19° 31' 13.157" E
K43	40° 26' 22.283" N	19° 31' 11.541" E
K44	40° 26' 19.568" N	19° 31' 12.324" E
K45	40° 26' 20.387" N	19° 31' 13.444" E



K46	40° 26' 19.952" N	19° 31' 13.984" E
K47	40° 26' 19.060" N	19° 31' 15.807" E
K48	40° 26' 19.285" N	19° 31' 17.168" E
K49	40° 26' 18.884" N	19° 31' 17.150" E
K50	40° 26' 19.680" N	19° 31' 19.787" E
K51	40° 26' 20.639" N	19° 31' 21.080" E
K52	40° 26' 21.048" N	19° 31' 24.777" E
K53	40° 26' 22.131" N	19° 31' 26.390" E
K54	40° 26' 23.710" N	19° 31' 26.558" E
K55	40° 26' 24.326" N	19° 31' 26.098" E
K56	40° 26' 24.289" N	19° 31' 24.785" E
K57	40° 26' 23.480" N	19° 31' 21.149" E
K58	40° 26' 22.920" N	19° 31' 19.654" E
K59	40° 26' 22.812" N	19° 31' 17.661" E
K60	40° 26' 23.936" N	19° 31' 15.962" E
K61	40° 26' 24.655" N	19° 31' 15.683" E
K62	40° 26' 25.254" N	19° 31' 16.094" E
K63	40° 26' 26.153" N	19° 31' 18.431" E
K64	40° 26' 26.752" N	19° 31' 19.398" E
K65	40° 26' 28.236" N	19° 31' 20.001" E
K66	40° 26' 29.441" N	19° 31' 17.803" E
K67	40° 26' 30.640" N	19° 31' 16.798" E
K68	40° 26' 31.260" N	19° 31' 17.684" E
K69	40° 26' 31.654" N	19° 31' 20.059" E
K70	40° 26' 32.205" N	19° 31' 20.452" E
K71	40° 26' 34.317" N	19° 31' 19.264" E

ANEKS 2 KOORDINATAT E ZONËS MBROJTËSE TË FSHATIT KANINË

Zona Mbrojtëse		
UTM Z 34N		
	Lat.	Long.
1	40° 26' 34.303" N	19° 31' 10.803" E
2	40° 26' 33.881" N	19° 31' 13.343" E
3	40° 26' 32.619" N	19° 31' 14.913" E
4	40° 26' 30.847" N	19° 31' 14.544" E
5	40° 26' 28.825" N	19° 31' 13.635" E
6	40° 26' 27.631" N	19° 31' 12.345" E
7	40° 26' 21.446" N	19° 31' 10.983" E
8	40° 26' 17.682" N	19° 31' 12.019" E
9	40° 26' 16.633" N	19° 31' 11.270" E
10	40° 26' 15.696" N	19° 31' 11.200" E
11	40° 26' 14.946" N	19° 31' 12.169" E
12	40° 26' 15.543" N	19° 31' 14.593" E
13	40° 26' 15.203" N	19° 31' 17.896" E
14	40° 26' 14.520" N	19° 31' 19.499" E
15	40° 26' 15.521" N	19° 31' 20.393" E
16	40° 26' 16.255" N	19° 31' 20.460" E
17	40° 26' 17.289" N	19° 31' 19.362" E
18	40° 26' 19.117" N	19° 31' 20.105" E
19	40° 26' 20.841" N	19° 31' 25.366" E
20	40° 26' 22.106" N	19° 31' 27.133" E
21	40° 26' 22.959" N	19° 31' 27.783" E
22	40° 26' 25.059" N	19° 31' 27.611" E
23	40° 26' 25.489" N	19° 31' 26.350" E
24	40° 26' 24.820" N	19° 31' 21.358" E
25	40° 26' 25.735" N	19° 31' 20.670" E
26	40° 26' 29.081" N	19° 31' 20.764" E
27	40° 26' 30.452" N	19° 31' 20.859" E
28	40° 26' 31.522" N	19° 31' 22.338" E
29	40° 26' 43.626" N	19° 31' 7.341" E
30	40° 26' 43.212" N	19° 31' 6.697" E
31	40° 26' 42.679" N	19° 31' 6.408" E
32	40° 26' 42.342" N	19° 31' 6.444" E
33	40° 26' 36.494" N	19° 31' 29.990" E
34	40° 26' 35.465" N	19° 31' 29.220" E
35	40° 26' 47.673" N	19° 31' 30.603" E
36	40° 26' 47.486" N	19° 31' 29.107" E
37	40° 26' 47.642" N	19° 31' 28.176" E
38	40° 26' 47.054" N	19° 31' 26.954" E
39	40° 26' 47.542" N	19° 31' 25.619" E
40	40° 26' 47.024" N	19° 31' 24.615" E
41	40° 26' 47.485" N	19° 31' 23.766" E
42	40° 26' 48.596" N	19° 31' 23.698" E
43	40° 26' 49.412" N	19° 31' 24.298" E
44	40° 26' 50.693" N	19° 31' 24.358" E
45	40° 26' 51.231" N	19° 31' 21.610" E
46	40° 26' 50.031" N	19° 31' 20.003" E
47	40° 26' 50.721" N	19° 31' 18.620" E
48	40° 26' 49.099" N	19° 31' 18.258" E
49	40° 26' 46.606" N	19° 31' 15.621" E
50	40° 26' 46.373" N	19° 31' 10.639" E
51	40° 26' 32.855" N	19° 31' 10.637" E
52	40° 26' 31.056" N	19° 31' 8.776" E
53	40° 26' 30.204" N	19° 31' 7.457" E
54	40° 26' 27.556" N	19° 31' 6.095" E
55	40° 26' 24.485" N	19° 31' 6.831" E
56	40° 26' 22.672" N	19° 31' 8.065" E
57	40° 26' 20.214" N	19° 31' 9.328" E
58	40° 26' 17.926" N	19° 31' 10.172" E
59	40° 26' 14.372" N	19° 31' 9.495" E
60	40° 26' 13.121" N	19° 31' 10.814" E

**VENDIM****Nr. 730, datë 16.9.2020**

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE
PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE MANZË, BASHKIA
DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë e re për zhvillim të territorit, me sipërfaqe prej 20 847 (njëzet mijë e tetëqind e

dyzet e shtatë) m², si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, në Njësinë Administrative Manzë, Bashkia Durrës.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike,

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;


ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	381407.69	4588791.95
2	381535.39	4588890.02
3	381618.67	4588798.11
4	381587.30	4588778.40
5	381575.79	4588768.75
6	381558.69	4588753.57
7	381555.94	4588751.37
8	381544.86	4588742.96
9	381534.23	4588735.43
10	381532.95	4588734.55
11	381516.39	4588719.67
12	381476.30	4588689.24
13	381475.13	4588690.94
14	381447.59	4588730.91
15	381444.27	4588735.87
16	381407.69	4588791.95



**VENDIM****Nr. 731, datë 16.9.2020****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E PËRGATITJES SË
SHESHEVE TË NDËRTIMIT NË
BASHKITË KURBIN, LEZHË DHE
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 191 253 259 lekësh (njëqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Durrës.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 49 633 459 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 65 164 800 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës

26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

c) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 76 455 000 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e procesit të transportit të materialeve të dala nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kurbin, Lezhë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 732, datë 16.9.2020****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT
OSE TË RIPARIMIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE, TË NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), SI
DHE MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI
OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKITË KRUIJË,
SHIJAK, DURRËS DHE TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 1 442 493 401 (një miliard e katërqind e dyzet e dy milionë e



katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e një) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, dhe rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 86 000 000 (tetëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 63 588 401 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e një) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin për rikonstruksion ose riparimin e

mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat);

c) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 763 250 000 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para;

ç) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 529 655 000 (pesëqind e njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë